

PHILIPS

Radio Portative

Seria 1000

TAR1659



Manuali i përdorimit

Regjistroni produktin tuaj dhe merrni ndihmë në:
www.philips.com/support

Përmbajtja

1	E rëndësishme	2
	Siguria	2
	Njoftim	3
2	Radioja juaj FM/AM	4
	Hyrje	4
	Çfarë ka në kuti	4
	Përmbledhje e radios FM/AM	4
3	Fillimi	6
	Instalimi i baterive	6
	Treguesi i Charge	6
	Mënyrat e karikimit	6
	① Karikim me USB	6
	② Karikim me energji diellore	6
	③ Karikim me manivelë	6
4	Dëgjoni radio FM/AM	7
	Shkoni në stacione radioje	7
	Rregullimi i volumit	7
5	Veçori të tjera	7
	Elektriku i dorës	7
	SOS	7
	Ngarkoni telefonin tuaj	7
6	Informacione për produktin	8
7	Zgjidhja e problemeve	8

1 E rëndësishme

Siguria

- Lexoni këto udhëzime.
- Përmblajuni të gjitha paralajmërimeve.
- Ndiqui të gjitha udhëzimet.
- Mos i bllokoni hapësirat e ajrimit. Instalojeni sipas udhëzimeve të prodhuesit.
- Mos e instaloni pranë asnjë burimi nxehtësie, si për shembull pranë radiatorëve, rrugëdaljeve të ngrohjes, sobave ose pajisjeve të tjera (duke përfshirë amplifikatorët) që prodhojnë nxehtësi.
- Të gjitha riparimet duhet të bëhen nga personat e kualifikuar të servisit. Kërkohet shërbimi kur pajisja është dëmtuar në ndonjë mënyrë, është derdhur lëng ose objekte kanë rënë brenda në pajisje, pajisja është ekspozuar ndaj shiut ose lagështisë, nuk funksionon normalisht, ose është rënë.
- KUJDES në përdorimin e baterisë - Për të parandaluar rrjedhjen e baterisë që mund të rezultojë në dëmtime trupore, dëme në pronë, ose dëm në radion portative:
 - Montojini të gjitha bateritë si duhet, + dhe - siç janë shënuar në aparat.
 - Mos i përzieni bateritë e vjetra me të reja. Mos i përzieni bateritë alkaline, standarde (karbon-zink) ose të rikarikueshme (ni-cad, ni-mh, etj.).
 - Hiqini bateritë kur aparati nuk përdoret për kohë të gjatë.
 - Bateria nuk duhet të ekspozohet ndaj nxehtësive të larta, si për shembull ndaj dritë së diellit, zjarrit ose të ngjashme.
 - Nëse bateria ndërrohet me një tip të gabuar, kjo mund të prishë sistemin mbrojtës;
 - Asgjësimi i një baterie në zjarr ose në një furrë të nxehtë, ose shtypja apo prerja mekanike e një baterie, mund të bëhet shkak për shpërthim;
 - Lënia e një baterie në një ambient rrethues me temperaturë jashtëzakonisht të lartë, si rrezet e diellit, zjarri ose sipërfaqja e nxehtë mund të bëhet shkak për një shpërthim ose rrjedhje të lëngut ose gazit të djegshëm.
 - Një bateri që i nënshtrohet trysnisë jashtëzakonisht të ulët të ajrit, kjo mund të bëhet shkak për një shpërthim ose rrjedhje të lëngut ose gazit të djegshëm.
- Bateritë përmbajnë substanca kimike. Ato duhet të asgjësohen në mënyrë korrekte.
- Nëse dyshoni se një bateri është gëlltitur ose është futur në ndonjë pjesë të trupit, kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore.
- Kur ndërroni bateritë, mbajini gjithnjë bateritë e reja dhe ato të përdorura larg fëmijëve. Sigurohuni që vendi i baterisë të jetë krejt i sigurt pasi ta ndërroni baterinë.
- Nëse vendi i baterisë nuk mund të sigurohet komplet, mos e përdorni më produktin. Mbajeni larg fëmijëve dhe kontakti prodhuesin.
- Kjo radio portative nuk duhet të ekspozohet ndaj pikimit ose spërkatjes.
- Mos vendosni burime të rrezikut mbi radion portative (p.sh., objekte të mbushura me lëngje, qirinj të ndezur).
- Ju lutem, kini parasysh se pajisja juaj përmban bateri litiumi të integruara. Kapaciteti i karikimit të baterive të litiumit do të bjerë me kalimin e kohës për shkak të karakteristikave të tyre të vetë-shkarkimit. Për të bërë të mundur jetëgjatësinë e baterisë së pajisjes suaj, ju rekomandojmë **të karikoni baterinë e integruar të litiumit me rreth 50% çdo 6 muaj gjatë kohës që pajisja nuk është në përdorim.**

Njoftim

Produkti u përmbahet kërkesave të Komunitetit Evropian për interferencat radio. Nëpërmjet këtij dokumenti, TP Vision Europe B.V. deklaron se produkti është në përputhje me kërkesat bazë dhe dispozitat e tjera përkatëse të RED Directive 2014/53/EU dhe Rregullores SI 2017 Nr 1206 të Pajisjeve Radio të MB. Mund ta gjeni deklaratën e konformitetit në www.philips.com/support.



Produkti u përmbahet kërkesave të Komunitetit Evropian për interferencat radio.



Ky produkt është bërë dhe është prodhuar me materiale dhe komponentë të cilësisë së lartë, të cilët mund të riciklohen dhe ripërdoren.




Ky simbol do të thotë se produkti nuk duhet të hidhet bashkë me mbetjet shtëpiake, por duhet të çohet në një pikë të përshtatshme grumbullimi për riciklim. Ndiqni rregullat lokale dhe asnjëherë mos e hidhni produktin dhe bateritë e karikueshme së bashku me mbeturinat e zakonshme shtëpiake. Hedhja e duhur e produkteve të vjetra dhe e baterive të karikueshme ndihmon në parandalimin e pasojave negative ndaj mjedisit dhe shëndetit të njeriut.



Ky simbol nënkupton se produkti përmban bateri që mbulohen nga Direktiva Evropiane (EU) 2023/1542 të cilat nuk mund të asgjësohen së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Informohuni rreth sistemit lokal të mbledhjes së veçantë për produktet elektrike dhe elektronike dhe për bateritë. Ndiqni rregullat vendëse dhe asnjëherë mos e hidhni produktin dhe bateritë së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Hedhja e duhur e produkteve të vjetra ndihmon në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Informohuni lidhur me sistemet vendëse për grumbullimin e produkteve elektrike dhe elektronike dhe të baterive. Ndiqni rregullat vendëse dhe asnjëherë mos e hidhni produktin dhe bateritë së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Hedhja e duhur e produkteve të vjetra ndihmon në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Heqja e baterive të integruara. Sigurohuni që produkti të jetë shkëputur nga kabloja e furnizimit me energji përpara se të hiqni baterinë e integruar.



Vetëm për qëllime ilustrimi

Informacione mjedisore

Të gjitha paketimet e panevojshme janë hequr. Sistemi juaj përbëhet nga materiale që mund të riciklohen dhe ripërdoren nëse çmontohen nga një kompani e specializuar. Lutemi, respektoni rregulloret lokale në lidhje me asgjësimin e materialeve të paketimit, baterive të harxhuara dhe pajisjeve të vjetra. Asgjësimi i një baterie në zjarr ose në një furrë të nxehtë, ose shtypja apo prerja mekanike e një baterie, mund të bëhet shkak për shpërthim.

2 Radioja juaj FM/AM

Urime për blerjen tuaj, dhe mirë se vini në Philips!
Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që ofron Philips, regjistroni produktin tuaj në www.philips.com/support.

Hyrje



Me këtë radio FM/AM, ju mund të

- dëgjoni radio FM/AM
- karikoni pajisjen tuaj celulare me kabllon USB
- përdorni funksionin e elektrikut të dorës për ndriçim
- shtypni butonin SOS për të kërkuar ndihmë në situatë urgjence

Çfarë ka në kuti

Kontrolloni dhe dalloni gjërat që ka në kuti:

- Njësia kryesore
- Udhëzues për fillimin e shpejtë
- Dokumenti i të dhënave të sigurisë
- Karta e Garancisë
- Kablloja USB e Tipit-C
- Rrip dore



Përmbledhje e radios FM/AM

① Antenë teleskopike

- Përmirëson marrjen e sinjalit FM/AM.

② Treguesi i Tune

- Drita e kuqe ndizet me marrjen e sinjalit të radios.

③ Treguesi i Charge

- Treguesi ndizet kur produkti është në karikim nga paneli diellor / manivela / USB.
- Treguesi pulson shpejt kur niveli i baterisë është i ulët.
- Treguesi fiket kur bateria karikohet plotësisht.

④ Tuning

- Në modalitetin FM/AM, rregullon një stacion me saktësi.

⑤ Volume


- Rregullon nivelin e zërit.

⑥ Ndërruesi i brezit

- Zgjidhni brezin FM/AM.

⑦ Ndërruesi i funksionit

- OFF / CHG. OUT / Li-ion Battery / AAA.



⑧ Elektri i dorës

- Funkzioni paralajmërues i dritës dhe blicit është i disponueshëm

⑨

- Shtypni për të ndezur/fikur funksionin e elektrikut të dorës.

⑩


- Shtypni për të lëvizur nga një modalitet i funksionit SOS në tjetrin:

·Sirenë (tingulli i alarmit)

·Dritë vezulluese

·Sirenë + dritë vezulluese

·Fikur




⑪ Priza DC IN

- Përdorni një kabllo USB TIPI-C për t'u lidhur me ushqyesin/furnizuesin me energji në mënyrë që njësia të karikohet.

⑫ Priza CHARGE OUT

- Përdorni kabllon USB për të bërë karikimin e një pajisje të jashtme.




⑬ Vendndodhja e Baterisë

- Instaloni 3 bateri AAA (nuk mundësohen)

⑭ Manovela

- Era për ngarkimin e Li-ion battery së integruar.



3 Fillimi

Ndiqui gjithnjë me radhë udhëzimet në këtë kapitull.


Instalimi i baterive



Kujdes

- Rrezik shpërthimi! Mbajini bateritë larg nga nxehtësia, drita e diellit ose zjarri. Asnjëherë mos i hidhni bateritë në zjarr.
- Bateritë përmbajnë substanca kimike, ndaj duhet të hidhen si duhet.
- Mos përzie lloje të ndryshme baterish: p.sh., alkaline me zink karboni. Përdorni vetëm bateri të të njëjtit lloj për pajisjen.

Vendosni 3 bateri AAA (nuk janë dhënë) me polaritetin e duhur (+/-) siç tregohet në figurë. Koha e funksionimit të radios me përdorimin e baterive AAA: Deri në 12 orë me volum 50%.



Treguesi i Charge

Statusi i baterisë	Treguesi i Charge
Bateri e ulët	Dritë e gjelbër që pulson shpejt
Në karikim	Jeshile solide
I karikuar plotësisht	Fikur




Mënyrat e karikimit

Njësia ka një bateri të rikarikueshme të integruar, e cila duhet të karikohet përpara se të përdorni radion FM/AM për herë të parë.

① Karikim me USB

Li-ion battery karikohet automatikisht kur njësia lidhet me ushqyesin e furnizimit me energji përmes kabllos të dhënë USB. Karikimi i plotë përmes USB-së zgjat 3,5 orë. Koha e funksionimit të radios me Li-ion battery: Deri në 32 orë me volum 50%.




Shënim

- Përdorni karikimin me energji diellore dhe prodhimin e energjisë me manivelë vetëm në raste emergjence.

② Karikimi me energji diellore

Pozicionoheni njësinë në diell, karikimi diellor do të nisë punën dhe treguesi i charge merr ngjyrë të gjelbër. **Mos e mbuloni panelin diellor gjatë kohës së karikimit.**




Shënim

- Niveli i dritës së rrezatimit diellor: 1000 W/m².
- Koha e funksionimit të radios me energjinë diellore: Kur rrezatimi diellor tejkalon 60000 Lux, produkti mund të ketë deri në 30 minuta kohë funksionimi me një volum të arsyeshëm dhe me një kohë karikimi 60 minuta.

③ Karikim me manivelë

Ju mund të rikarikoni baterinë e rikarikueshme e cila vjen e integruar duke rrotulluar gjeneratorin e manivelës. Treguesi i charge do të marrë ngjyrë të gjelbër.



Shënim

- Shpejtësia e fuqisë dalëse nominale: Gjeneratori i energjisë: 3000 rpm±50 rpm; Manivela: 120 rpm
- Koha e funksionimit të radios me energjinë e përfutur nga manivela: Rreth 60 minuta me një volum të arsyeshëm dhe me një kohë karikimi prej 25-minutash me shpejtësinë e manivelës prej 120 rpm. (rpm: Rrotullimet në minutë)

4 Dëgjoni radio FM/AM



Shënim

- Mbajeni radion FM/AM larg pajisjeve të tjera elektronike për të shmangur interferencën e radios.
- Për marrje më të mirë të sinjalit, shtrijeni plotësisht dhe rregulloni pozicionin e antenës.

Shkoni në stacione radioje

- Lëvizni ndërruesin e funksionit te **Li-ion Battery** ose **AAA** për të ndezur radion.
- Lëvizni ndërruesin e brezit për të zgjedhur ndërmjet brezit **FM/AM**.
- Rrotulloni çelësin e **Tuning** për të zgjedhur frekuencën FM/AM.
Frekuenca FM: 87,5-108 MHz
Frekuenca AM: 520-1710 kHz
- Treguesi i tune (i kuq) do të ndizet me kapjen e një kanali radioje të pastër.
- Për të fikur radion, lëvizni çelësin e funksionit në opsionin **OFF**.


Rregullimi i volumnit

Rrotulloni çelësin e **Volume** për të rregulluar nivelin e volumnit.

5 Veçori të tjera

Elektriku i dorës

Shtypni butonin  në anë për të ndezur funksionin e elektrikut të dorës. Shtypeni edhe një herë për ta fikur atë.



SOS

Shtypni butonin  për të aktivizuar SOS dhe për të lëvizur përmes modaliteteve të ndryshme:

Modaliteti 1: Sirenë


Modaliteti 2: Dritë vezulluese

Modaliteti 3: Sirenë + dritë vezulluese

Modaliteti 4: Fikur

Ngarkoni telefonin tuaj

- Lëvizni ndërruesin e funksionit te **CHG OUT**.
- Hapni kapakun prej gome të USB dhe lidhni celularin tuaj me produktin nëpërmjet kablos USB-C të dhënë.



6 Informacione për produktin

Shënim

- Informacionet për produktin mund të ndryshohen pa u njoftuar paraprakisht.

Energjia

Tipi i baterisë	Madhësia AAA (LR3) (nuk mundësohet)
Tensioni i baterisë	1,5 V
Numri i baterive	3
Bateri e Rikarikueshme	18650 2000 mAh
Tensioni i baterisë	3,7 V
Kapaciteti i Baterisë	2000 mAh
Numri i baterive	1

Tuner/Pranimi/Transmetimi

Bandat e tunerit	FM 87,5 - 108 MHz AM 520 - 1710 kHz
------------------	--

Mjedisi i punës

Lartësia mbi nivelin e detit	5000 m
Temperatura e funksionimit	0-45 °C

Zëri

Sistemi i zërit	Mono
Kontrolli i volumit	Rrotullues (analog)
Fuqia në dalje	1 W

Informacione të përgjithshme

Përmasat (Gje x La x Tra)	150 x 90 x 68 mm
Pesha (Njësia kryesore)	390 g

7 Zgjidhja e problemeve



Paralajmërim

- Asnjëherë mos e hiqni kasën e produktit.

Për ta mbajtur garancinë të vlefshme, asnjëherë mos u mundoni ta riparoni vetë pajisjen. Nëse hasni probleme ndërsa përdorni pajisjen, kontrolloni pikat e mëposhtme para se të kërkonti shërbime. Nëse problemi mbetet i pazgjidhur, shkoni në faqen e internetit të Philips (www.philips.com/support). Kur kontaktoni Philips, sigurohuni që pajisja është pranë dhe të keni gati numrin e modelit dhe numrin e serisë.

Asnjë zë/fuqi

- Volumi nuk është rregulluar. Rregulloni VOLUMIN.
- Bateritë janë të vdekura ose të vendosura gabimisht. Vendosni bateritë (e reja) në mënyrë të saktë
- Bateri e karikueshme Li-ion
- Kur vendosni bateri të reja, mos përpikuni të përziejni bateritë e vjetra me ato të reja.
- Hiqni bateritë nëse pajisja nuk do të përdoret për një kohë të gjatë. Bateritë përmbajnë substanca kimike, ndaj duhet të hidhen si duhet.
- Ju lutem, kini parasysh se pajisja juaj përmban bateri litiumi të integruara. Kapaciteti i karikimit të baterive të litiumit do të bjerë me kalimin e kohës për shkak të karakteristikave të tyre të vetë-shkarkimit. Për të bërë të mundur jetëgjatësinë e baterisë së pajisjes suaj, ju rekomandojmë **të karikoni baterinë e integruar të litiumit me rreth 50% çdo 6 muaj gjatë kohës që pajisja nuk është në përdorim.**

Marrje e dobët e sinjalit

- Për FM, zgjasni, përkulni dhe ktheni antenën teleskopike për pranimin më të mirë. Zvogëloni gjatësinë e saj nëse sinjali është shumë i fortë.
- Për AM, pajisja përdor një antenë të integruar. Drejtoni këtë antenë për pranimin më të mirë duke kthyer të gjithë pajisjen.



2025 © MMD Hong Kong Holding Limited. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Specifikimet mund të ndryshohen pa u njoftuar.

Philips dhe Philips Shield Emblem janë marka tregtare të regjistruara të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren me licencë. Ky produkt është prodhuar nga, dhe shitet nën përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited, ose të një prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi i vetëm në lidhje me këtë produkt.

Modeli: TAR1659/00_UM_V1.0

